



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 129/11 Prot.

Tiranë, më 21.05.2024

**V E N D I M**

**Nr. 148, Datë 148.05.2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 06, datë 23.01.2024<sup>1</sup>, e bërë nga A.B<sup>2</sup> kundër Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “ngjyrës”, “etnisë” dhe “shtetësisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, A.B, në mes të tjerash informon se: “Është dëshira ime të studioj për doktoratë në ekonomi në gjuhën shqipe në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës. Prandaj, paraprakisht do të doja të mësoja gjuhën shqipe në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, të Universitetit të Tiranës. Nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë kam marrë ftesën zyrtare për të studiuar gjuhë shqipe.

Kam 4 muaj (që nga tetori 2023) që përpiqem të aplikoj për vizë studimi, por pa sukses. Në disa raste kam informuar Ministrinë e Punëve të Jashtme, helpdesk-un e portalit e-albania dhe zyrtarë të tjerë të Republikës së Shqipërisë, për problemin specifik me të cilin jam përballur gjatë kohës së aplikimit për vizë studimi. Për më tepër, kam dërguar video dhe fotografi së bashku me e-mail-et e mëparshme në të gjitha këto institucione, në mënyrë që të mund të shpjegoja problemin teknik

<sup>1</sup> Ankesa është plotësuar me e-mail-in datë 01.02.2024.

<sup>2</sup> Referuar pasaportës nr. Z3195292, A.B, është shtetas i Republikës së Indisë.

me të cilin jam përballur gjatë aplikimit për vizë (online). Fatkeqësisht, me gjithë përpjekjet e mia të shumta, nuk kam marrë ende asnjë ndihmë teknike nga asnjë prej institucioneve, për të zgjidhur këtë problem. Duke ndjekur udhëzimet u përpoqa të aplikoja për leje qëndrimi, por si zakonisht, nuk arrita të dorëzoja aplikimin, duke marrë të njëjtin mesazh gabimi që kam marrë në çdo rast që nga nëntori 2023.

Ju lutem përpiquni të kuptoni problemin e saktë me të cilin jam përballur. Kjo për t'ju informuar se, nuk kam asnjë problem me lidhjen e internetit dhe me kompjuterin me të cilin kam bërë aplikimin në (<https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service code=15308>).

Prandaj, më parë isha në gjendje të dërgoja me sukses aplikacionin për vizë studimi së bashku me disa skedarë të mëdhenj të “Visa Type-C, Short Stay Visa-for the purpose of Study”, aplikimi numër: BEI-161123081116174241. Do të thotë që nuk kam asnjë problem me kompjuterin, lidhjen me internetin dhe me VPN. Fatkeqësisht, departamenti përkatës i vizave i Shqipërisë e ka refuzuar kërkesën time dhe më pas më ka sugjeruar që të aplikoj për një leje qëndrimi paraprakisht nëpërmjet kësaj lidhjeje specifike në internet:

<https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service code=15308>.

Ndoshta, disa gjëra thelbësore janë shkruar në lidhjen specifike të internetit nga zyrtarët përkatës të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Kërkesa online për leje qëndrimi pranë autoriteteve rajonale përgjegjëse për kufirin dhe migracionin duhet të bëhet brenda 30 ditëve pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke siguruar që aplikanti i huaj:

- Në momentin e aplikimit për leje qëndrimi është prezent në territorin e RSH-së;
- Ka qëndrim të rregullt në territor;

Do të thotë që gjatë kohës së aplikimit për leje qëndrimi, aplikanti duhet të jetë i pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto gjëra janë të shkruara në link-un e aplikimit i cili menaxhohet nga Ministria e Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

Megjithatë, që nga nëntori i vitit 2023, jam përpjekur të aplikoj për këtë leje qëndrimi nga territori i Indisë pasi jam një shtetas indian që jetoj në qytetin e Kolkatës, Indi. Fatkeqësisht, me gjithë përpjekjet e mia të shumta, nuk kam mundur të paraqes me sukses kërkesën time për leje qëndrimi.

Për këtë problem kam informuar në helpdesk-un e portalit e-albania që në nëntor 2023 dhe deri më sot kam marrë tre përgjigje (rasti juaj po verifikohet) në datë: 6 dhjetor, 27 dhjetor dhe 17 janar.

Kam dy pyetje për ju:

1. Helpdesk-u i portalit e-albania menaxhohet nga një autoritetet epror. Por pse po marrin kaq shumë kohë për të zgjidhur këtë problem (që nga 6 dhjetori 2023)?

2. Është shkruar në ueblink se gjatë kohës së aplikimit për leje qëndrimi, aplikanti duhet të jetë i pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Por pse departamenti juaj më ka kërkuar të aplikoj për leje qëndrimi nëpërmjet kësaj lidhjeje specifike në ueb??

Ndjej se ka racizëm kundër meje, dhe unë jam viktimë e racizmit për shkak të identitetit tim Indian me lëkurë kafe? Dikush nga Republika e Shqipërisë, nuk dëshiron që duke qenë një burrë Indian me lëkurë kafe, nuk duhet të shkoj në Republikën e Shqipërisë për të studiuar (për të mësuar gjuhën shqipe dhe më pas për të studiuar për një doktoraturë në ekonomi në gjuhën shqipe).

Do të ketë një mënyrë alternative për të zgjidhur këtë problem. Fatkeqësisht, me gjithë kërkesat e mia të shumta, askush nga departamenti i vizave i Republikës së Shqipërisë dhe helpdesk-u i e-albania, nuk më kanë dhënë ndonjë ndihmë”.

Subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe krijimin e mundësisë për të aplikuar për vizë.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkëlqet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 129/1, datë 07.02.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga institucionet për ankesën e bërë dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:

Nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme kërkohet:

- Informacion mbi arsyet e mos pajisjes me vizë/leje qëndrimi të shtetasit A.B.
- Kopje të të gjithë kërkesave/ankesave të ankuesit dhe përgjigjeve të dhëna nga ana e institucionit.
- Informacion lidhur me shtetas të tjerë nga India të cilët janë pajisur me vizë/leje qëndrimi, gjatë periudhës 2022-2023.
- Informacion nëse ka pasur ankesa nga shtetas të vendeve të tjera, të cilët janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, gjatë periudhës 2022-2023. Nëse po, kopje të ankesës dhe përgjigjes së dhënë nga institucioni.
- Informacion mbi procedurën që duhet të ndjekë shtetasi A.B për tu pajisur me vizë/leje qëndrimi.

Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit kërkohet:

- Kopje të të gjithë kërkesave/ankesave të ankuesit dhe përgjigjeve të dhëna nga ana e institucionit.
- Informacion nëse ka pasur ankesa nga shtetas nga India apo të vendeve të tjera, të cilët janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, gjatë periudhës 2022-2023. Nëse po, kopje të ankesës dhe përgjigjes së dhënë nga institucioni.
- Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 129/2, datë 19.03.2024, iu drejtua sërish institucioneve, me një kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe AKSHI kanë marrë dijeni për shkresën nr. 129/2, datë 19.03.2024, më datë 20.03.2024, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar: RR590215108AA dhe RR596612938AA, administruar në dosje por Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka kthyer përgjigje.

Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 725/2, datë 21.03.2024, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: “Referuar shkresës suaj, ju bëjmë me dije se bazuar në VKM nr. 243, datë 20.04.2022, në formularin e shërbimit Aplikim për Leje Qëndrimi aplikohet njëkohësisht për leje qëndrimi dhe vizë, nëse sipas vendit të rezidencës aplikuesi ka nevojë për një vizë për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas informacionit të plotësuar për arsyen e lejes së qëndrimit jepet edhe mundësia për të shtuar të dhënat e tjera të nevojshme të aplikimit për vizë nëpërmjet portalit e-visa.al. Aplikimi BEI-161123081116174241 është realizuar me datë 20.11.2023 përmes portalit e-visa.al për tipin e vizës C. Bazuar në ligjin nr. 79/2021 “Për të Huajt”, Neni 28, Pika 1, Germa B dhe E, nëse motivi i ardhjes në territorin shqiptar është për qëllime studimore duhet të aplikohet përmes shërbimit Aplikim për Leje Qëndrimi në portalin e-Albania.

A.B ka kontaktuar helpdesk@e-albania më datë 28.11.2023 dhe ka marrë përgjigjen se rasti i tij është duke u verifikuar në datën 04.12.2023. Nga verifikimet e realizuara nuk është evidentuar ndonjë problematikë me shërbimin Aplikim për Leje Qëndrimi. Në datë 06.12.2023 përsëri përmes helpdesk@e-albania i është kërkuar aplikuesit të përcjellë formularin e aplikimit me të dhënat e plotësuar si dhe mesazhin e gabimit që i shfaqet në përfundim të aplikimit, në mënyrë që të kryhen verifikime më konkretisht sipas të dhënave që ka plotësuar. Nga shqyrtimi i të dhënave të plotësuar nga ana e aplikantit rezultoi se formulari ishte plotësuar me të dhëna të sakta dhe nuk ishin përdorur në fusha karaktere të veçanta, përdorimi i të cilave do të pengonte validimin e ndonjë prej fushave që mund të sillte mos dërgimin me sukses të aplikimit. Shërbimi i përmendur sa më sipër është i hapur dhe nuk kërkon autentifikim për plotësimin e formularit të tij, dhe mund të aksesohet nga çdo shtetas i huaj pavarësisht kombësisë. Gjatë kësaj periudhe kur aplikuesi raporton vështirësitë që ka hasur rezulton se nëpërmjet shërbimit Aplikim për Leje Qëndrimi janë realizuar me sukses rreth 450 aplikime.

Lidhur me informacionin e kërkuar, nëse ka patur ankesa nga shtetas nga India apo vende të tjera në kushte të ngjashme me aplikuesin gjatë periudhës 2022-2023, bëjmë me dije se çdo raportim mbi problematika, vështirësi, paqartësi në përdorimin e shërbimit është ndjekur dhe zgjidhur me prioritet si dhe janë orientuar qytetarët që kanë kontaktuar nga çdo kombësi për çdo rast në veçanti.

Në këto kushte kur nga ana e shërbimit nuk rezulton asnjë pengesë, dhe pas verifikimeve ka rezultuar se shërbimi është plotësisht funksional dhe i aksesueshëm kudo dhe pa nevojën për tu identifikuar sugjerojmë të bëhen verifikime të rrjetit të internetit apo pajisjes nga e cila aplikanti ka tentuar të dërgojë aplikimin”.

Me shkresën nr. 129/3, datë 12.04.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme me Vendimin nr. 96, datë 12.04.2024, në të cilin institucioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është gjobitur në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga A.B.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 1980/1, datë 18.04.2024, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Me datë 16.11.2023 shtetasi ka aplikuar për vizë C-motive turistike në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Pekin, dhe dokumentacioni i ngarkuar ka rezultuar për motive studimore. Konsulli ka refuzuar aplikimin për vizë turistike të A.B me udhëzimin që të riaplikojë për vizë D për qëllime studimore.*

*Shtetasi Banerjee ka shkëmbyer me Ambasadën tonë në Pekin dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtorinë e Çështjeve Konsullore një mori komunikimesh elektronike prej muajit tetor 2023 deri në janar 2024, ku i është përcjellë me detaje procedura e aplikimit për vizë D/ST (studimore).*

*Nga verifikimi në sistemin e-visa.al rezulton se shtetasi nuk ka aplikime të tjera dhe rrjedhimisht nuk është trajtuar nga ana jonë asnjë kërkesë për vizë, pavarësisht gjithë informacionit dhe komunikimit të gjatë me të.*

*Lidhur me pretendimet për diskriminim për shkak të ngjyrës, ju informojmë se për vitin 2022 janë pajisur me vizë 1065 shtetas indianë, ndërsa për vitin 2023, janë pajisur me vizë 2491 shtetas indianë, gjithashtu përgjatë vitit 2022 shtetasit indianë kanë qenë përfitues të sezonit turistik, ku mund të hynin në territorin e Republikës së Shqipërisë pa pasur nevojë për vizë.*

*Nuk ka pasur asnjë ankesë apo problematikë të ngjashme si të shtetasit Banerjee, pasi procedurat e aplikimit për leje unike qëndrimi dhe vizë janë të publikuara në platformën e-albania dhe e-visa.al. Në komunikimin me AKSHI-n janë kryer verifikimet lidhur me pretendimet e shtetasit dhe është konstatuar se ka pasur asnjë pengesë teknike për të kryer procedurën normale të aplikimit për vizë.*

*Aplikimi për leje unike qëndrimi kryhet vetëm online në portalin e-albania në link: [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=15146](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15146) ku më pas aplikimi vijon në platformën e-visa.al. Në email-in e çdo shtetasi të huaj sistemi dërgon automatikisht udhëzimet për të gjithë fazat nëpër të cilat kalon aplikimi deri në finalizimin e aplikimit për vizë, që është gjenerimi i saj nga përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë pranë së cilës kryhet online procedura”.*

Në vijim Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr. 103, datë 22.04.2024, shfuqizoi Vendimin me gjobë nr. 96, datë 12.04.2024 dhe vendosi vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 6268/1, datë 14.05.2024, informoi Komisionerin se: *“Ju bëjmë me dije se nga verifikimet në sistemin e-visa.al nuk rezulton, që shtetasi A.B, të ketë kryer aplikim për vizë elektronike apo pullë për asnjë nënloj vize”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**



Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo

- shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
  - dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe AKSHI-n dhe më konkretisht në lidhje me aplikimin për vizë dhe leje unike qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

*Nga këqyrja e dokumentacionit, informacionit të dërguar dhe fakteve rezulton se:*

Në periudhën e muajve tetor-nëntor 2023, ankuesi ka aplikuar online për tu pajisur me vizë të tipit C, e cila i jep të drejtën që të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë deri në 90 ditë brenda 180 ditëve, duke filluar nga data e hyrjes së parë.

Nga shërbimi online [info@e-visa.al](mailto:info@e-visa.al), ankuesi në datë 20.11.2023 ka marrë njoftimin se pas verifikimit paraprak të aplikimit, rezulton se duhet të bashkëlidhen dhe disa dokumente të nevojshëm për aplikim si: fotografi të aplikuesit, dokument për strehimin, biletë udhëtimi vajtje/ardhje, gjendje të llogarisë bankare për një vit dhe vërtetim të punëdhënësit.

Gjithashtu, shërbimi [visa@mfa.gov.al](mailto:visa@mfa.gov.al) dhe [embassy.beijing@mfa.gov.al](mailto:embassy.beijing@mfa.gov.al), me email-et datë 14.11.2023 dhe 24.11.2023 kanë informuar ankuesin se: *“Republika e Shqipërisë ka ndryshuar procedurën për vizat e tipit D, për të huajt, nëpërmjet aplikimit për leje unike qëndrimi. Të gjithë qytetarët e huaj duhet të aplikojnë nëpërmjet portalit e-albania.al dhe të ndjekin udhëzimet për “Application for residence/Unique permit”, sipas linkut: xxxxxx. Kjo procedurë duhet të përfundohet përpara aplikimit për vizë. Ju do të merrni një email me udhëzimet që duhet të ndiqni për aplikimin për vizë nëpërmjet <https://e-visa.al>, dhe pas kësaj mund të vazhdoni me procedurën e aplikimit”*.

Pas këtij njoftimi, ankuesi ka kryer disa herë aplikimin për leje qëndrimi por nuk ka arritur ta përfundojë atë. Për këtë i është drejtuar disa herë shërbimit helpdesk2@e-albania, shërbimit [visa@mfa.gov.al](mailto:visa@mfa.gov.al) dhe shumë institucioneve të tjera.

Nga shërbimi helpdesk2@e-albania, ankuesi ka marrë përgjigje në datë 30.11.2023 (ju kërkohet që të nisni një video të aplikimit hap pas hapi, duke përfshirë dhe mesazhin, në mënyrë që të bëjmë verifikimet); datë 04.12.2023 (rasti juaj po verifikohet); datë 06.12.2023 (lutemi të na dërgoni formularin e aplikimit me të dhënat e plotësuar si dhe mesazhin e gabimit që ju shfaqet në përfundim të aplikimit, në mënyrë që të verifikojmë rastin tuaj); datë 07.12.2023 (rasti po verifikohet); datë 27.12.2023 (ju bëjmë me dije se rasti po verifikohet, sapo të kemi një përgjigje do t'ju njoftojmë); dhe datë 27.01.2024 (ju bëjmë me dije se rasti juaj po verifikohet me institucionin përgjegjës. Sapo të kemi një përgjigje do t'ju njoftojmë).



Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, Komisioneri ka analizuar aktet ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë procedurat në lidhje me aplikimin për vizë dhe leje unike qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr. 79, datë 24.06.2021 “Për të huajt” rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit të kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.

Neni 20 i ligjit të sipërcituar përcakton tipet e vizave. Kështu në nenin Neni 20.1, përcaktohet: “Viza e tipit “C” është viza që lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar në format elektronik, e cila i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë deri në 90 ditë brenda 180 ditëve, duke filluar nga data e hyrjes së pare”, ndërsa në nenin 21.1, përcaktohet: “Viza e tipit “D” është viza që lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar në format elektronik për shtetasit e huaj që synojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve, dhe kur, për t’u pajisur me leje qëndrimi, për këta shtetas kërkohet vizë”.

Në nenin 22 parashikohet se: “Autoritetet për lëshimin e vizave. 1. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme është institucioni përgjegjës për pajisjen me vizë të të huajit për të cilin kërkohet vizë për të hyrë, qëndruar ose transituar në Republikën e Shqipërisë”.

Në VKM nr. 858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë:

*“Kreu II. Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë: A. Kriteret të përgjithshme për tu pajisur me vizë: ..... 7. Për të aplikuar për vizë, shtetasi i huaj aplikon on-line në sistemin elektronik të vizave ose paraqitet personalisht në konsullatë apo, në rastet e marrëveshjeve dy-ose shumëpalëshe me vende të tjera, në përfaqësitë përkatëse të këtyre vendeve. Shtetasve të huaj pas miratimit të vizës në sistemin elektronik, në rast se kanë aplikuar për vizë elektronike, u gjenerohet kjo e fundit në postën e tyre elektronike. Në rast se kanë aplikuar për vizë pullë, paraqiten fizikisht në përfaqësitë diplomatike.*

*B. Dokumentacioni bazë i nevojshëm për të gjitha kategoritë për t’u pajisur me vizë:*

*1. Formulari i aplikimit për vizë, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i plotësuar dhe i nënshkruar nga aplikuesi, i cili gjendet on-line pa pagesë (formulari plotësohet on-line dhe shkarkohet nga sistemi).*

*C. Dokumentacioni shtesë që kërkohet sipas llojit të vizës, përveç dokumentacionit të përgjithshëm, në varësi të tipit të vizës së kërkuar.*

*I huaji duhet të paraqesë edhe dokumentacionin shoqërues, si më poshtë vijon:*

*3. Për vizë të tipit “D”: 3.1 Dokumentacioni i përgjithshëm:*

*a) Ftesa nga subjekti pritës, së bashku me fotokopjen e dokumentit të tij të identifikimit me përjashtim të rastit kur i huaji është investitor/i punësuar/i vetëpunësuar/punonjës lëvizës digjital në Republikën e Shqipërisë, pensionistë dhe përdorues të pasurisë së paluajtshme në Shqipëri që aplikon për vizë “D”;*

*b) Foto pasaporte me përmasat 47 mm x 36 mm;*

*c) Dokumenti që provon veprimtarinë apo aftësinë profesionale, tregtare në vendin e aplikuesit, me të cilin lidhen motivet e kërkesës së vizës së aplikuesit;*

*ç) Në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik të subjektit ftues;*

*d) Dokumenti që vërteton akomodimin në territorin e Republikës së Shqipërisë me përjashtim të punonjësve lëvizës digjitalë, për të cilët do të pranohet vetëdeklarim mbi ekzistencën e dokumenteve që provojnë akomodimin e përshtatshëm në Shqipëri, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;*

*dh) Dëshmia e miratimit për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për kategoritë që kanë detyrimin për miratimin paraprak për punësim sipas ligjit për të huajt.*

*3.5 Dokumentacioni shtesë për vizë për motive studimi (student dhe nxënës) D/ST:*

*a) Dokumenti, që vërteton pranimin në një institucion arsimor shqiptar;*

*b) Dëshmia financiare, që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit;*

*c) Certifikata që provon njohjen e gjuhës, me të cilën kërkuesi i vizës do të kryejë studimet. Prova e njohjes së gjuhës mund të verifikohet edhe me intervistë nga i ngarkuari me çështjet konsullore në ambasadë ose konsullatë.*

*III. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me leje qëndrimi.*

*A. Kriteret të përgjithshme dhe procedurat për t’u pajisur me leje qëndrimi:*

*1. Kërkesa për lëshimin e lejes së qëndrimit ose për ripërtëritjen e saj, si dhe miratimi i kërkesës bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt on-line.*

*5. Formulari standard i aplikimit të lejes unike është në aneksin nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një formular standard i aplikimit për leje unike qëndrimi, zbatohet ky formular.*

*Ç. Procedura e përgjithshme për t’u pajisur me leje unike, sipas skemës, pjesë përbërëse të vendimit. 1. Aplikimi për leje unike bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt on-line pas kryerjes*

së pagesës, e cila është e pakthyeshme. Në momentin e përfundimit të aplikimit të huajt i dërgohet një njoftim on-line për pranimin e aplikimit.

#### IV. Dispozita të fundit dhe kalimtare;

1. Procedura e aplikimit për lejet e qëndrimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë do të vijojë të kryhet në bazë të parashikimeve të vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik për të huajt nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, parashikuar në kreun III, seksioni D sipas këtij vendimi. Dispozitat e tjera të vendimit të sipërpërmendur shfuqizohen mehyrjen në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik për të huajt, sipas këtij vendimi, brenda datës 1 shtator 2022”.

Në Ligjin 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, parashikohet si më poshtë:

“Neni 14.1. Portali “e-Albania” është pika e vetme e kontaktit, e cila mundëson aksesin për kërkesë në shërbimet elektronike on-line të ofruara nga administrata publike, duke garantuar transaksionin elektronik të kryer, i cili gjeneron dokument elektronik. 2. Portali “e-Albania” ofron shkëmbimin e të dhënave në mënyrën elektronike me bazat e të dhënave të ndërlidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit, si dhe të shërbimeve elektronike në portal dhe në modulën e tij për nëpunësit e administratës publike për çdo person fizik dhe juridik, që ushtron funksionin në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. .... 4. AKSHI/institucioni shërbimofruës kërkon ndryshimin e sistemeve dhe të proceseve elektronike në to, krijimin e shërbimeve të reja elektronike, me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore nga portali “e-Albania”, si dhe monitoron përdorimin dhe mbarëvajtjen e portalit.

Neni 22.1. Autoriteti përgjegjës për qeverisjen elektronike është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në vijim AKSHI. 2. AKSHI është institucioni përgjegjës për infrastrukturën qendrore të shërbimeve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike të përqendruara, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për shërbimet publike.

Neni 26. Detyrat e AKSHI-t si krijues, zhvillues dhe administrues i sistemeve dhe i infrastrukturave AKSHI si krijues, zhvillues dhe administrues i sistemeve dhe i infrastrukturave të shërbimeve, sistemeve, portaleve dhe regjistrave, kryen detyrat e mëposhtme: a) është autoritet rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore;..... f) zhvillon, administron dhe mirëmban shërbimet elektronike të ofruara përmes platformës qeveritare “e-Albania””.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se ankuesi fillimisht ka aplikuar për vizë të tipit C), i cili nuk ka rezultuar se ishte i duhuri për qëllimin që ankuesi kishte për të hyrë në Shqipëri. Pas udhëzimit të Ministrisë për Evropën e Punët e Jashtme, ankuesi është

munduar për të kryer aplikimin për leje qëndrimi dhe vizë por për arsye teknike nuk ka arritur që të kryejë aplikimin. Nga ana e shërbimit helpdesk@e-albania, ankuesi në mënyrë të përsëritur ka marrë përgjigje që rasti është në proces verifikimi, por nga shërbimi i e-albania nuk është evidentuar ndonjë problematikë me vështirësitë e raportuara nga A.B gjatë procesit të aplikimit.

Në përgjigjen e dërguar nga AKSHI me nr. 725/2, datë 21.03.2024, evidentohet se nga ana e shërbimit e-albania nuk ka rezultuar asnjë pengesë, pasi shërbimi e-albania është funksional dhe i aksesueshëm kudo. Gjithashtu, AKSHI informon se nëpërmjet shërbimit “Aplikim për leje qëndrimi” janë realizuar me sukses 450 aplikime nga shtetas dhe shtete të ndryshme.

Gjithashtu dhe nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ankuesit i është sugjeruar tipi i aplikimit që duhet të kryente, për qëllime studimore. Në kushtet kur nuk ka pasur një aplikim të vlefshëm për vizë, pasi ankuesi nuk ka arritur që ta përfundojë atë, MEPJ nuk ka pasur asnjë mundësi për të zgjidhur kërkesën e A.B, pasi problemet e aplikimit kanë qenë teknike.

Referuar shkresës së sjellë nga MEPJ, në të cilën informon se gjatë vitit 2023, janë pajisur me vizë 2491 shtetas Indianë, rezulton se nga ana e MEPJ dhe nga AKSHI nuk ka pasur trajtim të pafavorshëm për ankuesin, për shkakun e pretenduar prej tij, pasi nga të dy institucionet janë krijuar mundësitë për të aplikuar dhe për tu pajisur me vizë dhe leje qëndrimi, shtetasit me të njëjtën shtetësi si ankuesi.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar

një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjekteve ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe AKSHI-t, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe AKSHI, kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të A.B nga ana e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**